



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerrë këtë:

Vendim Shpjegues Publik Nr. 02 /2012 ✓
për
Trajtimin e transaksioneve të Sigurimit dhe Ri-sigurimit

Neni 1
Qëllimi i Vendimit Shpjegues

Ky Vendim Shpjegues rregullon trajtimin për çështje tatimore nga aspekti i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) të transaksioneve, të realizuara nga Kompanitë e Sigurimeve dhe Ri-sigurimeve.

Administrata Tatimore e Kosovës, përmes këtij Shpjegimi Publik, për të siguruar trajtim të drejtë dhe të barabartë, informon të gjithë tatimpaguesit që ofrojnë shërbime nga fusha e sigurimeve dhe ri-sigurimeve, për mënyrën se si ATK-ja do të zbatojë dispozitën ligjore, respektivisht Nenin 28, paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Neni 2
Vendim

Të gjitha transaksionet nga Kompanitë e Sigurimeve dhe Ri-sigurimeve, duke përfshirë shërbimet e lidhura të bëra nga brokerat e sigurimit dhe agjentët e sigurimit, gjatë periudhës kalimtare 01.01.2010 deri me 31.12.2012, trajtohen si furnizime të tatueshme me të drejtën e zbritjes së TVSh-së së zbritshme.

Gjatë periudhës kalimtare, për furnizimet të cilat kanë të bëjnë me sigurimet dhe ri-sigurimet do të zbatohen rregullat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2004 të datës 01 shtator 2004 për zbatimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, bazuar në Rregulloren 2002/17 dhe Ligjin Nr. 03/L-114 për TVSh.

Neni 3
Subjekt i këtij Vendimi Shpjegues

Subjekt i këtij Vendimi Shpjegues janë të gjitha Kompanitë e Sigurimeve dhe Ri-sigurimeve.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky vendim sqaron implementimin e dispozitës ligjore të lartcekur gjatë periudhës kalimtare të paraparë me Nenin 64 të Ligjit Nr. 03/L-146 për TVSh, nga 1 janar 2010 deri më 31 dhjetor 2012.

Periudha kalimtare mund të zgjatet ose shkurtohet me propozimin e Ministrit të Financave dhe me miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në Nenin 64, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Data: 07 / 03 / 2012
Prishtinë,

Z. Behxhet Haliti

Drejtore e Përgjithshme të ATK-së

